

20100661179

L I G J PËR REVIZIONIN E INSTRUMENTIT PËR NDIHMË PARAADERUESE (IPA)

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë ligj rregullohen lënda e revizionit, organizimi dhe kompetencat e Organit të Revizionit dhe mënyra e kryerjes së revizionit të instrumentit për ndihmë paraaderuese në Republikën e Maqedonisë.

Neni 2

Nocionet e veçanta të përdorura në këtë ligj, e kanë këtë domethënie:

1. **Instrument për ndihmë paraaderuese** është ndihma paraaderuese financiare për periudhën 2007-2013, të cilën Unioni Evropian ua siguron vendeve kandidate dhe kandidatëve potencialë për anëtarësim në Unionin Evropian;

2. **Marrëveshje kornizë** është marrëveshja e lidhur ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Komisionit të Bashkësive Evropiane, për rregullat e bashkëpunimit në lidhje me ndihmën financiare të Komisionit Evropian për Republikën e Maqedonisë, në kuadër të realizimit të ndihmës sipas instrumentit për ndihmë paraaderuese, të ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë dhe të publikuar në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë" numër 18/2008 (në tekstin e mëtejme: Marrëveshja kornizë);

3. **Marrëveshje ndërmjet sektorëve** është marrëveshja e lidhur ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Komisionit të Bashkësive Evropiane, për rregullat e bashkëpunimit në lidhje me ndihmën financiare të Komisionit Evropian për Republikën e Maqedonisë dhe realizimi i ndihmës sipas Komponentit pesë (IPARD) nga instrumenti për ndihmë paraaderuese, të ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë dhe të publikuar në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë" numër 165/2008 (në tekstin e mëtejme: Marrëveshja ndërmjet sektorëve);

4. **Organ i revizionit për revizionin e instrumentit për ndihmë paraaderuese** është organi i themeluar sipas pikës 7 nga aneksi A i Marrëveshjes kornizë, si person juridik i mëvetësishëm dhe i pavarur i cili është funksional dhe i pavarur nga të gjithë pjesëmarrësit, në sistemet për menaxhim dhe kontroll me instrumentin për ndihmë paraaderuese;

5. **Subjekt i revizionit** është çdo person juridik dhe fizik i cili shfrytëzon mjete nga instrumenti për ndihmë paraaderuese;

6. **Koordinator kompetent për akreditim** është bartësi i funksionit publik i emëruar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë i cili është përgjegjës për dhënien, përcjelljen dhe heqjen ose tërheqjen e përkohshme të akreditimit nga Koordinatorin nacional për autorizim;

7. **Koordinator nacional për autorizim** është bartësi i funksionit publik i emëruar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë, i cili është përgjegjës për menaxhim financiar me mjetet e Unionit Evropian në Republikën e Maqedonisë dhe për funksionimin efektiv të sistemeve për menaxhim dhe kontroll në pajtim me instrumentin për ndihmë paraaderuese;

8. **Raport vjetor për aktivitetin e revizorit** është raporti i Organit të Revizionit, i përgatitur sipas modelit të përcaktuar në Aneksin V të Marrëveshjes kornizë;

9. **Mendim vjetor i revizorit** është mendimi i përgatitur nga Organi i Revizionit në bazë të modelit të përcaktuar në Aneksin G, të Marrëveshjes kornizë;

10. **Mendim vjetor i revizorit për llogaritë dhe ekstraktin e harxhimeve** është mendimi i përgatitur në bazë të modelit të përcaktuar në Aneksin D të Marrëveshjes kornizë, të parashtruar nga Koordinatorin nacional për autorizim të mjeteve nga instrumenti për ndihmë paraaderuese për zhvillim rural;

11. **Mendim i revizorit për ekstraktin përfundimtar të harxhimeve**, është mendimi i përgatitur në bazë të modelit të përcaktuar në Aneksin D të Marrëveshjes kornizë, të parashtruar nga Koordinatori nacional për autorizim për mbylljen e programit ose pjesëve të programit dhe

12. **OLAF (European Anti-Fraud Office)** është Zyra Evropiane për Parandalimin e Mashtrimit.

II. ORGANI I REVIZIONIT

Neni 3

(1) Punët e revizionit të sistemit për implementimin, menaxhimin dhe kontrollin e instrumentit për ndihmë paraaderuese në Republikën e Maqedonisë (në tekstin e mëtejme IPA), i kryen Organi i Revizionit për revizionin e instrumentit për ndihmë paraaderuese në Republikën e Maqedonisë (në tekstin e mëtejme: Organi i Revizionit).

(2) Selia e Organit të Revizionit është në Shkup.

Neni 4

(1) Me Organin e Revizionit udhëheq revizori kryesor për IPA-n.

(2) Revizori kryesor për IPA-n ka zëvendës.

(3) Revizorin kryesor për IPA-n dhe zëvendësin, i emëron dhe shkarkon Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

(4) Mandati i revizorit kryesor për IPA-n dhe zëvendësit është nëntë vjet, pa të drejtë të rizgjedhjes.

Neni 5

Revizori kryesor për IPA-n dhe zëvendësi, duhet t'i plotësojnë kushtet si vijojnë:

1) të jenë shtetas të Republikës së Maqedonisë;

2) të kenë arsim të lartë nga sfera e shkencave ekonomike ose juridike;

3) të kenë së paku shtatë vjet përvojë pune në sferën e ekonomisë ose drejtësisë;

4) të mos kryejnë funksion ose profesion tjetër publik, të mos jenë anëtarë në organe të partisë politike, anëtarë të Këshillit Drejtues, Këshillit Mbikëqyrës ose cilitdo organ tjetër te subjekti tjetër juridik dhe

5) të mos u është kumtuar sanksion për kundërvajtje, përkatësisht dënimi ndalim për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Neni 6

Mandati i revizorit kryesor për IPA-n dhe zëvendësit, pushon:

1) me skadimin e mandatit;

2) me kërkesën e tij;

3) me plotësimin e kushteve për pension;

4) në rast të vdekjes dhe

5) në rast të shkarkimit.

Neni 7

Revizori kryesor për IPA-n dhe zëvendësi, shkarkohen kur:

1) pushojnë t'i plotësojë kushtet nga neni 5 i këtij ligji dhe

2) nuk kanë mundësi që t'i kryejnë detyrat më gjatë se gjashtë muaj për shkak të sëmundjes ose shkaqeve tjera të arsyeshme.

Neni 8

(1) Revizori kryesor për IPA-n, e paraqet dhe përfaqëson Organin e revizionit, siguron kryerje të ligjshme dhe efikase të punëve dhe detyrave, udhëheq dhe e organizon punën e Organit të revizionit.

(2) Revizori kryesor për IPA-n dhe zëvendësi, janë personat e vetëm për kontakt me Komisionin Evropian për të gjitha çështjet e lidhura me revizionin e IPA-s.

Neni 9

Revizori kryesor për IPA-n, në kuadër të të drejtave dhe detyrave të veta të përcaktuara me këtë ligj, i kryen veçanërisht detyrat si vijojnë:

- 1) e propozon buxhetin e Organit të Revizionit;
- 2) e miraton planin vjetor për revizion;
- 3) e përcakton mënyrën e kryerjes së revizionit të IPA-s;
- 4) i parashtron raportet dhe mendimet e revizionit, në pajtim me nenin 26 paragrafi (1) i këtij ligji;
- 5) i miraton aktet për zbatimin e këtij ligji;
- 6) e përcakton formën dhe përmbajtjen e legjitimacionit zyrtar, si dhe mënyrën e dhënies dhe heqjes së të njëjtit;
- 7) e miraton aktin për organizimin dhe punën e Organit të Revizionit dhe aktin e sistematizimit të vendeve të punës në Organin e revizionit;
- 8) vendos për të drejtat dhe obligimet e të punësuarve në Organin e revizionit, në pajtim me ligjin;
- 9) miraton akt për mënyrën e udhëheqjes së procedurës disiplinore në Organin e Revizionit;
- 10) formon komisione dhe trupa tjerë punues, në kuadër të Organit të revizionit;
- 11) komunikon me mediumet me qëllim të informimit të publikut për punën e Organit të Revizionit dhe
- 12) kryen edhe punë tjera të përcaktuara me këtë ligj.

Neni 10

Zëvendësi e zëvendëson revizorin kryesor për IPA-n, në rast të pengesës ose mungesës së tij, me të gjitha autorizimet dhe përgjegjësitë e tij dhe kryen punë të cilat do t'ia ngarkojë revizori kryesor për IPA-n.

Neni 11

Revizori kryesor për IPA-n dhe zëvendësi, nuk mund të thirren në përgjegjësi penale ose të arrestohen, për qëndrimet, mendimet dhe rekomandimet e paraqitura në lidhje me punën.

Neni 12

(1) Mjetet për punën e Organit të Revizionit, sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

(2) Buxheti i Organit të Revizionit përgatitet në kuadër të limiteve të përcaktuara vjetore, në pajtim me strategjinë e përcaktuar fiskale dhe paraqet pjesë integrale të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë.

(3) Kuvendi i Republikës së Maqedonisë në mënyrë të veçantë e voton pjesën e dedikuar për Organin e Revizionit, në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë.

Neni 13

(1) Rroga e revizorit kryesor për IPA-n dhe zëvendësit, përcaktohet në pajtim me dispozitat për rrogat e personave të emëruar dhe të zgjedhur.

(2) Rrogën e revizorëve të IPA-s, e përcakton revizori kryesor për IPA-n, në kuadër të buxhetit të përcaktuar të Organit të Revizionit.

Neni 14

(1) Personat e punësuar në Entin Shtetëror për Revizion të sistemuar për kryerjen e punëve dhe detyrave të punës në Organin e Revizionit, në pajtim me Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për revizion shtetëror ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 133/2007), do të vazhdojnë të punojnë në Organin e revizionit, me ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(2) Me pushimin e obligimeve të punës në Organin e Revizionit, me realizimin e IPA-s, personat nga paragrafi (1) i këtij neni transferohen me punë në Entin Shtetëror për Revizion dhe sistemohen në vendin përkatës të punës me titull të njëjtë.

III. REVIZORËT E IPA-S

Neni 15

Punët e revizionit të IPA-s në Republikën e Maqedonisë, i kryejnë revizorët e instrumentit për ndihmë paraaderuese (në tekstin e mëtejshëm: revizorët e IPA-s).

Neni 16

(1) Revizorët e IPA-s duhet t'i plotësojnë kushtet, si vijojnë:

- 1) të jenë shtetas të Republikës së Maqedonisë;
- 2) të kenë arsim të lartë nga sfera e shkencave ekonomike, juridike, teknologjisë informatike ose arsim tjetër përkatës dhe
- 3) të deklarojnë se gjatë punës do t'i zbatojnë rregullat e përcaktuara me Kodeksin e etikës të standardeve për revizion të pranuar ndërkombëtarisht.

(2) Revizorët e IPA-s kanë legjitimacion me të cilin dëshmohet cilësia e tyre zyrtare dhe gjatë kryerjes së revizionit obligohen që ta tregojnë.

(3) Revizorët e IPA-s obligohen që revizionin e IPA-s ta kryejnë në pajtim me nenin 18 të këtij ligji.

(4) Revizorët e IPA-s nuk mund të thirren në përgjegjësi, për mendimin e dhënë në lidhje me kryerjen e autorizimeve zyrtare.

Neni 17

Revizorët e IPA-s nuk guxojnë të kryejnë revizion, nëse:

- 1) paraprakisht kanë qenë në marrëdhënie pune ose kanë qenë përfaqësues ligjorë të subjektit të revizionit, së paku pesë vjet para kryerjes së revizionit;
- 2) kanë marrë pjesë në udhëheqjen e librave të punës ose e kanë përpiluar llogarinë vjetore dhe raportet financiare të subjektit të revizionit, së paku pesë vjet para kryerjes së revizionit;
- 3) janë bashkëshortë ose janë në bashkësi jashtëmartesore, farefis nga gjaku në vijë të drejtë deri në shkallën e tretë të farefisnisë me pronarin ose përfaqësuesin ligjor të subjektit të revizionit dhe
- 4) janë themelues, aksionarë ose bashkëpronarë në subjektin e revizionit.

IV. KRYERJA E REVIZIONIT TË IPA-S

Neni 18

Organi i Revizionit kryen revizion të IPA-s, në pajtim me standardet ndërkombëtare për revizion.

Neni 19

(1) Revizioni i IPA-s sipas dispozitave të Marrëveshjes kornizë dhe Marrëveshjes së sektorëve, dhe sipas këtij ligji i përfshin:

- 1) verifikimin e funksionimit efektiv të sistemeve për udhëheqje dhe kontroll për IPA dhe

2) verifikimin e vërtetësisë së informatave të kontabilitetit të dorëzuara nga institucionet kompetente në Republikën e Maqedonisë të Komisioni Evropian, gjatë udhëheqjes së decentralizuar me fondet e Unionit Evropian.

(2) Puna e revizionit e përfshin revizionin e ekzemplarit adekuat të aktiviteteve ose të transaksioneve dhe kontrollin e procedurave.

(3) Llojet e revizionit të IPA-s, janë:

- 1) revizioni i sistemit IPA (revizion sistemor);
- 2) revizioni i projekteve/programeve;
- 3) revizioni financiar dhe
- 4) revizioni i teknologjisë informatike (Revizioni TI).

Neni 20

(1) Organi i revizionit mundet që para se t'i qaset kryerjes së revizionit, të kërkojë nga subjekti i revizionit që t'i sigurojë të gjitha informatat të cilat janë të nevojshme për kryerjen e revizionit duke i përfshirë dokumentet, të dhënat ose informatat tjera të cilat janë të domosdoshme për planifikimin dhe kryerjen e revizionit.

(2) Subjekti i revizionit obligohet që t'i sigurojë informatat e kërkuara nga paragrafi (1) i këtij neni, në afat prej pesë ditësh pune nga dita e pranimit të kërkesës.

Neni 21

(1) Gjatë kryerjes së revizionit, revizorët e IPA-s kanë qasje të lirë në lokalet zyrtare dhe pronën, të drejtën e kontrollit të librave, formularëve dhe dokumentacionit tjetër, të dhënat elektronike dhe sistemet e informimit, si dhe të drejtë që të kërkojnë sqarime nga përfaqësuesit e subjektit të revizionit për të gjitha çështjet të cilat janë të rëndësishme për kryerjen e revizionit.

(2) Përfaqësuesi ligjor i subjektit të revizionit, obligohet që revizorit të IPA-s t'i paraqesë në dispozicion dhe t'i sigurojë kopje të dokumentacionit të nevojshëm, dokumenteve personale, raporteve dhe evidencave tjera dhe t'i japë informata tjera të domosdoshme për zbatimin e revizionit.

(3) Subjekti i revizionit nuk guxon që ta kufizojë vëllimin e kontrolleve ose ta pamundësojë zbatimin e procedurave të caktuara të revizionit. Organi i Revizionit obligohet që këtë në mënyrë adekuate ta paraqesë në raport, në pajtim me standardet e revizionit dhe menjëherë ta njoftojë organin kompetent i cili e kryen mbikëqyrjen e subjektit.

Neni 22

Gjatë kryerjes së revizionit të IPA-s, revizori kryesor për IPA-n sipas nevojës mund të angazhojë edhe persona profesionistë dhe ekspertë nga institucionet adekuate.

Neni 23

Organi i Revizionit pa kompensim financiar ka qasje të plotë në të gjitha informatat dhe dokumentet e personave juridikë dhe fizikë, të cilët janë të lidhur me projekte ose programe të cilat janë të financuara plotësisht ose pjesërisht me mjetet e IPA-s në Republikën e Maqedonisë.

Neni 24

(1) Dokumentet të cilat e kanë shenjën e informatës së klasifikuar, përfaqësuesi ligjor i subjektit të revizionit obligohet që revizorit të IPA-s t'ia paraqesë në dispozicion, në mënyrë të përcaktuar me ligj.

(2) Revizorët e IPA-s obligohen që me informatat e klasifikuara, të veprojnë në pajtim me dispozitat e Ligjit për informatave të klasifikuara.

(3) Revizorët e IPA-s nuk guxojnë që t'i shfrytëzojnë njohuritë të cilat i kanë marrë gjatë kryerjes së revizionit, për fitimin e dobisë pronësore ose dobisë tjetër për vete ose për subjekt tjetër.

(4) Dispozitat nga paragrafi (2) dhe (3) të këtij neni, kanë të bëjnë edhe me personat profesionistë dhe ekspertët nga neni 22 i këtij ligji.

V. PLANI VJETOR I PUNËS PËR REVIZION, RAPORTET DHE MENDIMET E REVIZORIT

Neni 25

(1) Revizioni i IPA-s kryhet sipas Planit vjetor të punës për revizion. Planit vjetor i punës për revizion i përfshin aktivitetet e revizionit të planifikuara për realizim për periudhën prej 12 muajsh, nga 30 shtatori i vitit rrjedhës përfundimisht deri më 30 shtator të vitit të ardhshëm.

(2) Planit vjetor i punës për revizion, i dorëzohet Koordinatorit nacional për autorizim dhe Komisionit Evropian, më së voni deri më 30 shtator të vitit rrjedhës.

Neni 26

(1) Në pajtim me Marrëveshjen kornizë dhe Marrëveshjen e sektorëve, Organi i revizionit dorëzon:

1) raport vjetor për aktivitetet e revizorit i cili i përmban mjetet e shfrytëzuara nga Organi i Revizionit, pasqyrën e të gjitha dobësive të zbuluara në sistemet për udhëheqje dhe kontroll ose konstatimet për transaksionet e përcaktuara me revizionet e kryera, në pajtim me Planin vjetor të punës për revizion. Raporti vjetor për aktivitetet e revizorit i dorëzohet më së voni deri më 31 dhjetor për çdo vit Komisionit Evropian dhe Koordinatorit nacional për akreditim, ndërsa një kopje i dorëzohet edhe Koordinatorit nacional për autorizim;

2) mendim vjetor të revizorit është mendimi për funksionimin efektiv të sistemeve për udhëheqje dhe kontroll me IPA-n dhe për harmonizimin e kërkesave të përcaktuara me Marrëveshjen kornizë dhe Marrëveshjen e sektorëve, Rregullativën për realizimin e IPA-s si dhe Marrëveshjet tjera të lidhura ndërmjet Komisionit Evropian dhe Republikës së Maqedonisë. Mendimi vjetor i revizorit së bashku me Raportin vjetor për aktivitetet e revizorit, i dorëzohet Komisionit Evropian dhe Koordinatorit nacional për akreditim, ndërsa një kopje i dorëzohet Koordinatorit nacional për autorizim. Mendimi vjetor i revizorit përgatitet për periudhë të njëjtë dhe dorëzohet në afatin e njëjtë si edhe Raporti vjetor për aktivitetet e revizorit;

3) mendimi vjetor i revizorit për llogaritë dhe ekstraktet për mjetet nga Komponenti pesë i IPA-s (IPARD), të parashtruara nga Koordinatorit nacional për autorizim në Komisionin Evropian, e i cili ka të bëjë me vitin financiar paraprak. Ky mendim i revizorit së bashku me Raportin vjetor për aktivitetet e revizorit më së voni deri më 30 prill, i dorëzohet Komisionit Evropian dhe Koordinatorit nacional për akreditim dhe

4) mendim të revizorit për ekstraktin përfundimtar të harxhimeve i dorëzuar nga Koordinatorit nacional për autorizim në Komisionin Evropian, për mbylljen e programit ose pjesëve të programit, së bashku me Raportin përfundimtar për aktivitetin e revizorit. Ky mendim i dorëzohet Komisionit Evropian dhe Koordinatorit kompetent për akreditim, në të njëjtën kohë ose më së voni në afat prej tre muajsh nga parashtrimi i ekstraktit përfundimtar të harxhimeve.

(2) Koordinatorit nacional për autorizim, obligohet që në afat prej 45 ditësh nga dita e pranimit të raporteve të revizorit, me shkrim ta njoftojë revizorin kryesor për IPA-n të Organit të Revizionit për masat e ndërmarra.

Neni 27

(1) Për informimin e opinionit, Organi i Revizionit e ka faqen e vet të internetit (ueb).

(2) Raportet dhe mendimet e Organit të Revizionit nuk publikohen në faqen e internetit (ueb).

VI. BASHKËPUNIMI

Neni 28

Nëse revizorët e IPA-s gjatë kryerjes së revizionit konstatojnë se ekziston dyshim i bazuar se është kryer kundërvajtje ose vepër penale, për këtë menjëherë i njofton organet kompetente, në pajtim me marrëveshjet bilaterale dhe rregulloret e OLAF-it.

Neni 29

Subjektet të cilat mbajnë evidenca administrative, regjistra dhe baza të të dhënave dhe bartësit e qarkullimit pagesor, obligohen që të dhënat për subjektet të cilat janë objekt i revizionit të revizorëve të IPA-s, t'i dorëzojnë në mënyrë të përcaktuar me ligj.

Neni 30

(1) Organi i Revizionit për realizimin e aktiviteteve të veta bashkëpunon me organet dhe institucionet shtetërore të Republikës së Maqedonisë, vendet anëtare të Unionit Evropian dhe vendet candidate për anëtarësim në Unionin Evropian.

(2) Organi i Revizionit mund të kryejë revizione të përbashkëta me Organet e revizionit të vendeve tjera, me Komisionin Evropian dhe me Gjykatën Evropiane të Revizorëve.

VII. REVIZIONI I PUNËS SË ORGANIT TË REVIZIONIT

Neni 31

(1) Revizionin e punës së Organit të Revizionit e kryen shoqata për revizion e cila ka leje pune për kryerjen e punëve të revizionit, Komisioni Evropian dhe Gjykata Evropiane e Revizorëve.

(2) Raporti nga revizioni i kryer i shoqatës për revizion nga paragrafi (1) i këtij neni, i dorëzohet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë më së voni deri më 30 qershor të vitit rrjedhës.

VIII. DISPOZITAT PËR KUNDËRVAJTJE

Neni 32

(1) Gjobë në shumë prej 3 000 deri në 6 000 euro me kundërvlerë në denarë, do t'i kumtohet për kundërvajtje personit juridik-subjektit të revizionit, nëse:

1) nuk ia paraqet në dispozicion revizorit dokumentacionin e nevojshëm, dokumentet personale, raportet dhe informatat tjera për kryerjen e revizionit (neni 21 paragrafi (2)) dhe

2) revizorëve të IPA-s ua kufizon vëllimin e kontrolleve ose ua pamundëson zbatimin e procedurave të caktuara të revizionit (neni 21 paragrafi (3)).

(2) Gjobë në shumë prej 1 000 deri në 2.000 euro me kundërvlerë në denarë, do t'i kumtohet për kundërvajtjen nga paragrafi (1) i këtij neni edhe personit përgjegjës te personi juridik i subjektit të revizionit.

Neni 33

Gjobë në shumë prej 3 000 deri në 6 000 euro me kundërvlerë në denarë, do t'i kumtohet për kundërvajtje personit fizik-subjektit të revizionit, nëse:

1) nuk e paraqet në dispozicion të revizorit dokumentacionin e nevojshëm, dokumentet personale, raportet dhe informatat tjera për kryerjen e revizionit (neni 21 paragrafi (2)) dhe

2) revizorëve të IPA-s ua kufizon vëllimin e kontrolleve ose ua pamundëson zbatimin e procedurave të caktuara të revizionit (neni 21 paragrafi (3)).

Neni 34

Gjobë në shumë prej 500 deri në 1 000 euro me kundërvlerë në denarë, do t'i kumtohet për kundërvajtje personit fizik-revizorit të IPA-s, nëse revizionin nuk e kryen në pajtim me nenin 16 paragrafi (3) i këtij ligji.

Neni 35

Para parashtrimit të kërkesës për ngritjen e procedurës për kundërvajtje para Gjykatës kompetente, kryerësit të kundërvajtjes do t'i ofrohet barazimi në pajtim me Ligjin për kundërvajtje.

IX. DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 36

(1) Qeveria e Republikës së Maqedonisë e emëron revizorin kryesor për IPA-n dhe zëvendësin e Organit të Revizionit, në afat prej një muaji nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(2) Udhëheqësi i Organit të Revizionit, i përcaktuar në pajtim me Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për revizion shtetëror ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 133/2007), vazhdon ta kryejë funksionin deri në emërimin e revizorit kryesor për IPA-n.

Neni 37

(1) Revizori kryesor për IPA-n, në afat prej dy muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, e përcakton mënyrën e kryerjes së revizionit të IPA-s dhe i miraton aktet e përcaktuara me këtë ligj.

(2) Deri në hyrjen në fuqi të dispozitave nga paragrafi (1) i këtij neni, do të zbatohen dispozitat ekzistuese.

Neni 38

Me ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, mjetet, dokumentacionin e punës dhe arkivin e IPA-s, nga Enti Shtetëror për Revizion i merr Organi i Revizionit.

Neni 39

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë".